



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 19/2018 (JR)
Datë 11.10.2018

Vendim nr. 3/1 (JR)
Datë 19.04.2019

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim kryesisht, në dhomë këshillimi, më datë 19.04.2019, ditën e premte në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, propozimin e bërë me shkresën nr. 19/3 (JR) regjistri, datë 09.04.2019, nga gjyqtarja relatore, për korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin me arsyetimin e plotë nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, me:

Objekt: Ndreqja e gabimeve materiale në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 3 (JR), datë 07.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi.

Bazë ligjore: Neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016); neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, (në vijim ligji nr. 49/2012); neni 312 i Kodit të Procedurës Civile.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi, propozimin e gjyqtarës relatore të çështjes mbi nevojën për ndreqjen e gabimeve materiale në vendimin nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin e tij nr. 3 (JR), datë 07.02.2019, ka lënë në fuqi vendimin nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi. Po më datë 07.02.2019, vendimi me arsyetim të përmbledhur nr. (JR) 3, i është komunikuar subjektit të rivlerësimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe është konfirmuar komunikimi i këtij vendimi.
2. Vendimi me arsyetimin e plotë nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, i është komunikuar vetë subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 08.04.2019, të cilët kanë konfirmuar po ashtu marrjen e tij.
3. Pas komunikimit të këtij vendimi subjektit të rivlerësimit, gjyqtarja relatoe ka konstatuar disa gabime në shkrim, të bëra në pjesën arsyetuese të tij dhe, me anë të shkresës nr. 19/3, datë 09.04.2019, ka njoftuar për këtë konstatim kryesuesin dhe anëtarët e trupit gjykues duke propozuar ndreqjen e tyre.
4. Referuar kërkesës së gjyqtares relatoe, nga kryesuesi i trupit gjykues është nxjerrë urdhri nr. 19/4, datë 11.04.2019, për thirrjen e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, datë 19.04.2019, ora 10:00, për ndreqjen e gabimeve në vendimin nr. (JR) 3, datë 07.02.2019. Ky urdhër për thirrjen e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 11.04.2019 i është njoftuar subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të ONM-së, të cilët kanë konfirmuar marrjen e tij.
5. Në shkresën nr. 19/3, datë 09.04.2019, të cituar më lart, gjyqtarja relatoe propozon ndreqjen e gabimeve në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, për sa vijon:
 - a) Në paragrafin 58 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës” duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pika 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës”.
 - b) Në fjalinë e parafundit të paragrafit 74 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës” duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës”.
 - c) Në fjalinë e fundit të paragrafit 74 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës” duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës”.
 - d) Në paragrafin e fundit të vendimit para pjesës urdhëruese, togfjalëshi “nenin Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës”, duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “nenin Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës”.
6. Trupi gjykues, pasi u njoh me këto konstatime të gabimeve materiale dhe propozimin për korrigjimin e tyre, duke analizuar paragrafët e pjesës arsyetuese të vendimit në të cilët janë konstatuar gabimet në shkrim të referuara më sipër, konstaton se:

- 6.1. Në paragrafët e cituar më lart, është përdorur baza ligjore e parashikuar nga Aneksi i Kushtetutës, e konkretisht neni Dh, pikat 4 e 5 të tij, ndërkohë që neni Dh i Aneksit të Kushtetutës ka në përmbajtje të tij vetëm katër pika, pra dukshëm pika e pestë e shkruar në këta paragrafë është një gabim në shkrim, duke qenë se neni Dh, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës nuk ekziston.
 - 6.2. Gjithashtu, në analizë të përmbajtjes së vendimit me arsyetim të përmbledhur nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, që i është komunikuar subjektit në ditën e shpalljes së tij, nuk konstatohen këto gabime në shkrim. Në të pasqyrohet saktë baza ligjore e përdorur në mbështetje të zgjidhjes së çështjes, e cila është neni Dh, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës.
 - 6.3. Duke përdorur konstatimet e mësipërme, Kolegji çmon se në rastin konkret gjendemi pikërisht para gabimeve në shkrim në pjesën përshkuese-arsyetuese të vendimit, ndreqja e të cilave vetëm korrekton këto gabime, pa ndryshuar aspak qëndrimin e Kolegjit qoftë në arsyetimin e tij dhe aq më tepër në disponimin e tij në pjesën urdhëruese.
 - 6.4. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se situata është pikërisht ajo që rregullohet nga neni 312 i Kodit të Procedurës Civile, i cili legjitimon gjykatën që të ndreqë gabimet në shkrim kryesisht. Kolegji vlerëson se zbatimin e nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile e dikton parashikimi i nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile, në rast se situatat ligjore të prezantuara për zgjidhje nuk gjejnë një zgjidhje të posaçme nga vetë ligji nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji çmon se duhet të procedohet me korrigjimin e këtyre gabimeve e vendosjen në paragrafët e përshkruar më lart, të dispozitës së saktë kushtetuese, e cila pasqyron mbështetjen ligjore të përdorur prej Kolegjit në arsyetimin e zgjidhjes së çështjes.
7. Në vijim të konstatimeve të mësipërme, Kolegji vlerëson të drejtë të ndreqë gabimet në shkrim të konstatuara si më poshtë.
- a) Në paragrafin 58 të vendimit në të cilin shkruhet: *subjekti i rivlerësimit është konsideruar se ka plotësuar kushtet për t'u konsideruar i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës në kuptim të nenit Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, paragrafët 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016*, e gjithë përmbajtja dhe arsyetimi i bërë në këtë paragraf lidhet me evidentimin e fakteve mbi bazën e të cilave Komisioni e ka konsideruar subjektin e rivlerësimit se ka plotësuar kushtet për t'u konsideruar i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Referuar përmbajtjes së këtij paragrafi, trupi gjykues konstaton se përdorimi i saktë dhe i synuar nga Kolegji në këtë pjesë do të ishte përdorimi i bazës ligjore të parashikuar nga neni Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës, gjithashtu të reflektuara në nenin 61, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 84/2016, të cilat janë shkruar gabimisht si bazë ligjore në këtë paragraf të vendimit, si neni Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës.
 - b) Në fjalinë e parafundit të paragrafit 74 të vendimit në të cilën shkruhet: *rrethanë kjo që e bën atë të gjendet në kushtet e nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016*, konstatohet se, ndërkohë që gjithë përmbajtja e tij ka të bëjë me faktin e gjetjes së prezantuar gjatë procesit të rivlerësimit, sipas së cilës shtetasi A. I është konsideruar si kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, është shkruar gabimisht si bazë ligjore për klasifikimin e situatës, neni Dh, pika 4 e Aneksit

të Kushtetutës, i pasqyruar në nenin 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në referim të përmbajtjes së nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, është e qartë që kjo dispozitë rregullon rastet e deklarimit të pamjaftueshëm për kontakte të papërshtatshme, ndërkohë që dispozita kushtetuese që rregullon pasjen e kontaktit të papërshtatshëm e që harmonizohet me nenin 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është pikërisht neni Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto rrethana, ky gabim në shkrim duhet të ndreqet si më lart, duke respektuar edhe qëllimin e synuar të Kolegjit në shkrimin e këtij arsytimi.

- c) Në fjalinë e fundit të paragrafit 74 të vendimit, në të cilën thuhet se *fakti që subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien me këtë shtetas në formularin për kontrollin e figurës, pavarësisht se rezulton që ky kontakt të ketë ekzistuar, e bën subjektin të gjendet në kushtet edhe të nenit Dh, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstaton se gabimisht është referuar te pika 5 e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, e cila nuk ekziston. Për më tepër, në këtë pjesë të këtij paragrafi përmbajtja pasqyron mosdeklarimin e kontaktit të papërshtatshëm nga subjekti i rivlerësimit të formulari i deklarimit dhe është referuar saktësisht referenca ligjore të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e parashikon këtë rast, fakt i cili logjikisht do të kërkonte parashikimin si bazë kushtetuese të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës në vend të nenit Dh, pika 5 e tij.
- ç) Lidhur me gabimin e konstatuar në pjesën e fundit arsytuese të vendimit, para pjesës urdhëruese, në të cilën shkruhet se *bazuar në nenin Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 2 e 3 dhe në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016*, duke përdorur arsytimin e përshkruar më lart, trupi gjykues çmon se gjithashtu gjendemi para shkrimit të gabuar të normës kushtetuese, e cila duhet të ndreqet edhe në këtë paragraf, duke cituar si referencë të saktë nenin Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës.

8. Përfundimisht, Kolegji në mbështetje të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Pas shpalljes së vendimit, gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo me kërkesën e palëve ose kryesisht mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra me shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit [...], duhet bërë ndreqja e gabimeve në shkrim të përshkruara më lart, në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, duke saktësuar përmbajtjen e tij sipas konstatimeve të mësipërme.*
9. Trupi gjykues vlerëson se me anë të ndreqjes së këtyre gabimeve, nuk ndryshohet vullneti i Kolegjit, i formuar me rastin e dhënies së vendimit që konkretizohet me shpalljen e tij, dhe as nuk preket përmbajtja e dispozitivit të vendimit nr. (JR) 3, datë 07.02.2019.
10. Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi propozimin e gjyqtarës relatores, çmon se është e nevojshme të kryhet ndreqja e gabimeve të konstatuara në formën e përshkruar më lart, në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në zbatim nenit 4 pika 6 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Ndreqjen e gabimeve të bëra në shkrim në arsyetimin e vendimit nr. (JR) 3, datë 07.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, si më poshtë:
 - Në paragrafin 58 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës” zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës”.
 - Në fjalinë e parafundit të paragrafit 74 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës” zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës”.
 - Në fjalinë e fundit të paragrafit 74 të vendimit, togfjalëshi “nenit Dh, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës” zëvendësohet me togfjalëshin “nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës”.
 - Në paragrafin e fundit të vendimit, para pjesës urdhëruese, togfjalëshi “nenin Dh, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës”, zëvendësohet me togfjalëshin “nenin Dh, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës”.
2. Ky vendim i bashkohet vendimit nr. JR (3), datë 07.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.
U shpall në Tiranë, sot, më datë 19.04.2019.

ANËTARE

Albana Shtylla
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta Schuetz
nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj
nënshkrimi

RELATORE

Ina Rama
Nënshkrimi

KRYESUES

Sokol Çomo
nënshkrimi